



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes: PER:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, U.D i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave MAPL	Datë: 20/11/2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës	Nr.020-1293
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,


Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-40 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 14-463/01-0263669/18 për këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës nr.7196-3 me pronën e paluajtshme në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnica dhe Liman (Beqir) Jashari me nr. 7195-7 me destinim ndërtimin e rrugës sipas planit rregullues "Arbëria 3"
I miratuar më datë: 31.10.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.11.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Shpend Ahmeti, gradonačelnik Opštine Priština Agim Kuleta, predsedavajući Skupštine opštine Priština	
Cc:	Jedinici za upravljanje dokumentima, MALS Jedinici za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko: ZA:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Čerkini, v.d. rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština MALS	Datum: 20.11.2018. Br. 020-1293
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Opštine Priština	
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativnu raspravu akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i Ministarstva, odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđen članom 81 Zakona br.03/L-05 o lokalnoj samoupravi:

Odluka br. 14-463/01-0263669/18 za razmenu nepokretne imovine opštine br.7196-3 sa nepokretnom imovinom u vlasništvu Nexhat (Shaban) Dumnnica i Liman (Beqir) Jashari sa br. 7195-7 sa odredištem izgradnja puta prema regulativnom planu "Arbëra 3".	
Usvojena dana: 31.10.2018. godine.	
Dostavljena za razmatranje MALS-u dana: 07.11.2018. godine.	

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvoditi pravni efekat.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitivave të nenit 17, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/V - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), 4 të Ligjit nr. 04/V - 044, për themelien në shpirtëzimin dhe këmbimin e pronë-
si ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 34 të shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 110-391 Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, morr këtë

Prishtinë, më 07.11.2018

Ministria e Administrimit Lokal, Prishtinë
Ministry of Local Government Administration

07.11.2018

№	Titulli	Adresa	Vendi
-VI-	020-4293		

V E N D I M

- I. **MIRATIMI** i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Neshat (Shaban) Dummeës dhe Luan (Beqir) Jashari.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 7196-3, Zona Kadastrale (ZK) Prishtinë, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07196-3, e evidentuar si pronë shoqërore, kurse pronat e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesë e parcelës kadastrale nr. 7196-7, ZK Prishtinë, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07196-7 e destinuar për interes publik "rrugë" sipas Planit rregullues "Arbëria 3" Prishtinë, në pronësi të Neshat (Shaban) Dummeës dhe Luan (Beqir) Jasharit.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshkruara për realizimin e Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë. Kjo i shërben si frytëzimi për qëllime të interesit publik të komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para sipërfaqes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të këmbëhet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit të Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë shkresat e lëndës.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunes.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
14-463901-0263669/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo – Republic of Kosovo
 Komuna e Prishtinës
 Opština Prishtina – Municipality of Prishtina



Na osnovu člana 17, stav 2.2, slovo d Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosova, br. 28/17, juni 2008. godine) člana 11, stav 1, 2 i 4 Zakona br. 04-L/144 o davanju na korišćenje i izmeni nepokretne imovine opštine (Službeni list Republike Kosova, br. 28/17, juni 2008. godine) člana 33.2, slovo a, i člana 34.1, slovo d Statuta Opštine Prishtina (Službeni list Opštine Prishtina, br. 25/12, 2017. god.) Skupština Opštine Prishtina na sednici održanoj 31.10.2018. usvojila je sledeće:

Opština e Administrimit të Pushtetit Lokal Opština Lokale Samouprave / Administration Municipality of Local Government Administration	
Data: 07.11.2018	
Loket:	
Titulli:	
Kodi:	
Shifra identifikuese të Komunitetit	Shifra identifikuese të Opštine
-VI-	020-1293

ODLUKA

- I. **USVAJA SE** predlog predsednika za razmenu nepokretne opštinske imovine sa nepokretnom imovinom u vlasništvu vlasnika Nexhat (Shaban) Dumitica i Liman (Beqir) Jashari.
- II. Nepokretna imovina koja će se dati za razmenu, ima sledeće karakteristike: deo katastarske parcele br. 7198-3, Katastarska Zona Prishtina, certifikat imovine P-71914059-07196-3, evidentirana kao društvena svojina, a nepokretna imovina koja se uzima sa ove razmene je: deo katastarske parcele br. 10178-0, Katastarska Zona Prishtina, evidentirana u Certifikatu imovine P-71914059-10178-0, u vlasništvu
- III. Nepokretna imovina koja će se dati za razmenu, ima sledeće karakteristike: deo katastarske parcele br. 7196-3, Katastarska Zona (KZ) Prishtina, certifikat imovine br. P-71914059-07196-3, evidentirana kao društvena svojina, a nepokretna imovina koja se uzima sa ove razmene je: deo katastarske parcele br. 7196-7, KZ Prishtina, certifikat imovine br. P-71914059-07196-7, namenjena za javni interes "put" na osnovu regulacionog plana "Arberia 3" Prishtina, pod vlasništvu Nexhat (Shaban) Dumitica i Liman (Beqir) Jashari.
- IV. Razmena nepokretnosti je izvršena zato što ne postoje druge opštinske parcele pogodne za sprovođenje urbanističkog regulacionog plana "Arberia 3" u Prishtini. Ovo služi u svrhu korišćenja javnog interesa opštine i kapitala za finansiranje razmene je obezbeđeno.
- V. Prije javnog objavljivanja odluke biće izvršena kvalifikovana procena tržišne vrednosti nepokretnosti opštine i procena privatne imovine
- VI. Način i uslovi razmene nepokretne imovine utvrđuju se ugovorom, koji će se vezati i potpisati između Predsednika Opštine i vlasnika katastarske parcele koja će se razmeniti.2.
- VII. Opštinska nepokretna imovina koja će se razmeniti, opisana u tački II ove odluke, treba se evidentirati u katastarskim knjigama opštine.

- VIII. Za sprovođenje ove odluke nadležan je: predsjednik opštine, Direkcija za imovinu i Katastarska Direkcija opštine Priština.
- IX. Sastavni dio ove odluke su beleške o predmetu.
- X. Ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon što se registruje u Kancelariji za protokol Ministarstva za lokalnu samoupravu i nakon objavljivanja na zvaničnom jeziku na veb-stranici Opštine.

SKUPŠTINA OPŠTINE PRISTINA
14 463/01-0263669/18, 01.11.2018

PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
Agim Kuleta





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe të nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më dt. ____, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Nexhat (Shaban) Dumnica dhe Liman (Beqir) Jashari.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 7196-3, , Zona Kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P71914059-07196-3, e evidentuar si pronë shoqërore, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 7196-7, Zona Kadastrale Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07196-7, e destinuar për interes public rrugë sipas Planit Rregullues “Arbëria 3” Prishtinë, në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnica dhe Liman (Beqir) Jashari.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistonë parcela tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit Rregullues “ Arbëria 3” në Prishtinë. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interes publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të këmbëhet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

_____, më _____

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Agim Kuleta



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-643

Në bazë të dispozitave të nenit 21 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 21 të Ligjit të Planifikimit Hapësinor nr.04/L-174 të dt.23.08.2013, nenit 18, paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17, pika "d", të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës nr.110-391 dt.25.02.2010, nenit 13, nënparagrafi 4.1 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II- të, të ndërtimeve duke vendosur sipas kërkesës me nr.05-350/02-0071877/18, dt.26.03.2018, të pronarit **Nexhat Dumnica** dhe **Liman Jashari** nga Prishtina, rr. 'Ahmet Krasniqi', p.nr. lagja 'Arbëria 3' me investitor '**Dumnica Group**' sh.p.k. me adresë në lagjen 'Ulpiana', 'U1', lokali 8/B, në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, në kuadër të bllokut "C4.1", të tërësisë hapësinore "Veranda", të Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3", në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me dt.03.08.2018, merr këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

- I. I CAKTOHEN kushtet ndërtimore pronarit Nexhat Dumnica dhe Liman Jashari nga Prishtina, me investitor 'Dumnica Group' sh.p.k., me seli në Prishtinë, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet 3B-S+P15 dhe sipërfaqe mbi tokë ~4330.8 m², në kuadër të bllokut urban "C4.1", të tërësisë hapësinore "Veranda", të Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3" në Prishtinë, në parcelat kadastrale nr.7196-4, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale nr.P-71914059-07196-4 dhe nr.7196-5, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale nr.P-71914059-07196-5 ZK Prishtinë, dhe në parcelen kadastrale 7196-3, në pronësi të 'P.S.H. Komuna e Prishtinës', në këmbim me pjesë të parcelës kadastrale nr.7196-7 ZK Prishtinë (të planifikuar për interes publik – infrastrukturë rrugore) sipas propozimit të kërkuarit.
- II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore gjendet në kuadër të Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01-35-94056 dt. 04.05.2015, ku sipas këtij Plani, kjo zonë është e paraparë zonë e banimit të lartë. Lidhur me këtë dhe parametrat e ndërtimit nga ky Plan, kërkuar është informuar me "Informimin nga Plani Rregullues Ndryshimi dhe Plotësimi "Arbëria 3" me referencë 1087 dt.16.10.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.
- III. Gjendja ekzistuese:
 - Parcela kadastrale me nr.7196-4 ka sipërfaqe totale prej 1100m², me pronar Nexhat Dumnica nga Prishtina, me klasë të kualitetit 'Arë e klasës 3';
 - Parcela kadastrale me nr.7196-5 ka sipërfaqe prej 864m², me pronar Nexhat Dumnica nga Prishtina, me klasë të kualitetit 'Arë e klasës 3';

- Parcela kadastrale nr.7196-7, ka sipërfaqe të përgjithshme prej 10966m², dhe me klasë të kualitetit: "arë e klases 3", me bashkëpronarë Liman Jashari dhe Nexhat Dumnica, /pjesë e parcelës/parcela e propozuar për këmbim, me pjesë të parcelës kadastrale nr.7196-3, me sipërfaqe prej 442m², në pronësi të "P.SH. Komuna e Prishtinës";
 - E drejta pronësoresh-juridike e parcelave kadastrale është private, tokë e pandërtuar urbane me infrastrukturë;
 - Tereni ka pjerrtësi, në drejtimin veri-jug, me disnivel prej ~4.5m;
 - Parcelat kadastrale kanë qasje direkte në rrugën ekzistuese dhe të planifikuar, në anën veriore të këtyre parcelave "Nora e Hotit", si dhe në rrugën e planifikuar në anën juglindore.
- Me këtë projekt konceptual- "zgjdhje urbane", trajtohet sipërfaqja prej 2406 m².**

IV. Kushtet për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin e ndërtesave, janë:

- Bazuar në kushtet dhe kriteret e Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues "Arbëria 3", parcelat kadastrale nr.7196-4 dhe 7196-5 ZK Prishtinë, bën pjesë në bllokun urbanistik "C4.1", të tërësisë hapësirë "Veranda", të planifikuara si zonë për banim të lartë.
- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, gabariti i ndërtesave, pozicionimi i ndërtesave dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike, e që janë pjesë përbërëse e këtij Vëndimi;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore ISPN, pra sipërfaqja e lejuar ndërtuese mbitokësore për parcelat e lartëcekura, llogarritet për sipërfaqen prej 2406m², ku Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore ISPN për bllokun "C4.1" është 1.8, pra 2406m² x 1.8 =4330.8m².
Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim:
100% për etazhet mbi kuotën ±0.00, 50% për etazhet me vëllim mbi 51% apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës – bodrum
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës ISHP, për vendosjen e ndërtesave në bazë – gabarit të përdhësës lejohej max.0.3 (30%) dhe kjo sipërfaqe e shputës së ndërtesave është 2406x0.3=721.8m²;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN) për vendosjen e ndërtesave në bazë – gabarit të bodrumit lejohej max.=60%, dhe kjo sipërfaqe është 2406x0.6=1443.6m² e sipërfaqes së parcelave brenda vijës rregulluese të bllokut "C4.1",
- Indeksi i shfrytëzimit të gjelbrimit (ISGJ) duhet të jetë min.40%, dhe kjo sipërfaqe është 2406x0.4=962.4m²,
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale në mes të ndërtesave (shumëbanesore apo afariste) duhet të jetë h+1/2h, kurse e ndërtesave me kufirin e parcelës fqinje 0.75h ku ka hapje për kthinë primare, 0.25h ku ka hapje të kthinave sekondare dhe 0-0.25 II me marrëveshje në fqinje kurse bodrumi mund të vendoset nga fqinji (kufiri i parcelës) në distancë prej 1.5m ose 0 m me marrëveshje.
- Etazhiteti maksimal i lejuar në bllokun "C4.1", tërësia hapësirë "Prerija" është P+5;
- Ngritja e nivelit të përdhësës të ndërtesave nga niveli i terrenit - trotuarit të ndërtesave, lejohej të jetë max.1.2m, ndërsa, për ndërtesa që në përdhësë kanë tregti apo shërbime afariste, kuota e përdhësës mund të jetë më e madhe se kuota e trotuarit për (max) 0.3m;
- Ballkonet mund të kalojnë vijën ndërtimore max. 1.2m. Konzollat më të mëdha se 1.2m, nuk lejohej të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore;
- Shkallët e jashtme të hapura të cilat kanë lartësinë mbi 1.2m, nuk lejohej të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore;
- Rampat duhet të planifikohen në atë mënyrë që të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve si dhe nuk lejohej të vendosen mes vijës rregulluese dhe ndërtimore;
- Për çdo njësi banesore të planifikohet 1 (një) vendparkim/1 banesë, me kusht që së paku 20% të planifikohen mbi tokë, kurse për pjesët afariste të ndërtesave varësisht prej destinimit të parashihen parkimet, ku për çdo 40m² (neto) / 1 vendparkim;
- Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore, afariste dhe ndërtesave tjera publike nuk duhet të rrethohen, përveq çerdheve/kopshteve dhe shkollave;

- Dukja e jashtme e ndërtesës: inkurajohet përdorimi i materialeve natyrore (tullë, dru, gurë e të ngjashme), kulmi mund të jetë i pjerrët apo i rrafshët, këndi maksimal i kulmit të pjerrët duhet të jetë 45°, nuk lejohet aplikimi i kulmit mansardë, nuk lejohet përdorimi i ngjyrave bazë, inkurajohet përdorimi i ngjyrave pastele, materialet duhet të reflektojnë destinimin e ndërtesës, nuk lejohet përdorimi i dritareve-pasqyrë dhe me ngjyrë, inkurajohet arkitekturë e thjeshtë, e pastër, pa shumë detaje, të minimizohet përdorimi i materialeve të rrezikshme, etj.;
- Në kuadër të kompleksit, të planifikohet edhe mobiliari urban, pllato, kënde të lodrave për fëmijë e të ngjajshme;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Nëpër lokacion duhet përcaktuar pika për deponimin e mbeturinave në kontejnerë. Këto hapësira përveç që duhet pasur qasje të lehtë nga rruga, ato gjithashtu duhet të jenë vizuelisht të izoluar, mos të pengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve dhe të veturave.

V. KËMBIMI SIPAS PROPOZIMIT TË KËRKUESIT, i pronës private me pronë komunale, konkretisht këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr.7196-7 evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-07196-7 ZK Matičan, në bashkëpronësi të Liman Jasharit dhe Nexhat Dumnica, me sipërfaqe totale prej 10966m², pjesa e destinuar për rrugë të planifikuar sipas "Ndryshimit dhe Plotësimit të Planit Rregullues Arbëria 3", në Prishtinë, me pjesën e parcelës kadastrale nr.7196-3 ZK Prishtinë, në pronësi të 'P.SH. Komuna e Prishtinës', aktualisht në shfrytëzim për parking të ndërtesës së Komunës së Prishtinës, me sipërfaqe prej 442m² (brenda vijës rregulluese të bllokut "C4-1"), me destinim "Zonë e ndërtimit miks" dhe me koeficient ndërtimi "1.8". Këmbimi duhet të bëhet në sipërfaqe të nevojshme në bazë të vlerësimit të organit kompetent për vlerësimin e pronave.

Sipas Planit "Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit Rregullues Arbëria 3", të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01-35-94056 dt. 04.05.2015, për bllokun urban "C4", plani ka propozuar rritjen e sipërfaqes për banim, ku pjesmarrës është edhe parcela në pronësi komunale. Sipas propozimit, parkingu ekzistues i ndërtesës së Komunës së Prishtinës, duhet të ridizajnohet ose të shiqohet mundësia e ndërtimit nën tokë, ku një nga mundësitë është edhe ndërtim në marrveshje në mes të Komunës dhe investitorit privat.

Se cila formë e implementimit të planit do të zbatohet, mbetet në kompetencë të Drejtorisë së Pronës, e cila është njësi përgjegjëse për menaxhimin me pronat komunale.

Nëse zbatohet propozimi i kërkuesit për këmbim, procedura e këmbimit duhet të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit & investitorit, duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të dt. 22.11.2012, thuhet se "Komuna ka të drejtë të këmbëjë pronën e paluajtshme komunale me persona fizik dhe juridik, në rastet kur një këmbim i tillë nevojitet për sigurimin e tokës për qëllime të shfrytëzimit për interes publik".

Mos zbatimi i procedurës së parapartë sipas këtij paragrafi - pike, nga pronari dhe investitori, për arsye të ndryshme, do ta obligojë Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë këtë Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. Ndarja/parcelimi i parcelës kadastrale nr.7196-3, ZK Prishtinë, do të realizohet sipas vijës rregulluese të bllokut urban "C4-1", kurse ndarja e parcelës kadastrale nr. 7196-7 ZK Prishtinë, të bëhet sipas këmbimit në sipërfaqe të nevojshme në bazë të vlerësimit të organit kompetent për vlerësimin e pronave..

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit-"zgjidhja urbane" dhe "*Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01*", punuar nga kjo drejtori. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit & investitorit, duke u bazuar "*Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ*

KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Bashkimi i parcelave kadastrale, dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr.7196-4, 7196-5 ZK Prishtinë, si dhe pjesa e parcelës kadastrale 7196-3 ZK Prishtinë, pas këmbimit me pjesë/parcelë kadastrale 7196-7 ZK Prishtinë, sipas parcelës ndërtimore bazuar në Planin e situacionit – "zgjidhja urbane" dhe manualin e ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, do të bëhet në një parcelë ndërtimore.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave & pjesëve të parcelave të lartcekura sipas, Planit të situacionit-"zgjidhja urbane". Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin e këtyre ndryshimeve, në operatën kadastrale.

Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve & investitorit, duke u bazuar në planin e situacionit-"zgjidhja urbane" dhe manualin e bashkimit, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe panjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

IX. Hartimi i dokumentacionit ndërtimor/projekti kryesor, të bëhet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, Rregulloren MMPH Nr.03/2016, për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashëpronësi si dhe për hapësirat në funksion të tyre, projekt propozimin e prezantuar, UA MMPH nr.08/2017 për normat minimale teknike të planifikimit hapësinor dhe bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri, si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit të gjerë, në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe ndërtesën e planifikuar, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane", në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesës, në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës të projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për objektin e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zoçtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit-oborrit, me rrugë, shtigje, mobilierin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje të nevojshme;

- Projektin e instalimeve elektro - energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin elektro - energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafo stacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
